



# **RIINVEST**

**BPrAL KOLEGJI RIINVEST SH.A.**

**RREGULLORJA PËR ARKËTIM**

**Shkurt 2019**

Në pajtim me kompetencat e dhëna në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës (Nr. 06/L-016 ) dhe Statutin e rregulloren për financa BPrAL Riinvest miraton Rregulloren për Arkëtim

## **1. Qëllimi**

1.1 Të vendoset përgjegjësi për pagesa të studentëve, të definoj dhe hartoj dispozitat lidhur me vonesën në pagesa dhe të tjera.

## **2. Procesi që garanton regjistrimin e studentit/es dhe pagesat e shpenzimeve**

2.1 Regjistrimi - Të përgjithshme:

Studentët me rastin e lidhjes së kontratës krijon detyrime financiare ndaj Kolegjit Riinvest. Studenti/ja që ka obligime financiare të mbajtura ose që kanë një bilanc të papaguar nga një semestër i mëparshëm, nuk do të lejohen të regjistrohet semestri, paraqitja e provimeve dhe ofrimi i shërbimeve të administratës derisa të realizohet detyrimi financiar.

2.2 Regjistrimi i rregullt:

Studentët janë përgjegjës për pagesën e plotë, të tarifës së studimit dhe të gjitha tarifave tjera të përcaktuara deri në datën e parashikuar për afatin e pagesës. Dështimi për të paguar semestrin dhe të gjitha borxhet e tjera në kolegji dhe për të përmbush të gjitha "obligimet e mbajtura" do të rezultojë në ndërprerjen e studentit/es në MIS, E-learning, si dhe në vijueshmërinë tuaj në mësim. Është përgjegjësia e studentit të paguajë obligimet financiare sipas kartelës financiare të deklaruar në momentin e nënshkrimit të kontratës.

2.3 Regjistrimi pas afatit:

Studentët që regjistrohen pas datës së paraparë do të paguajnë taksën e vonshme të regjistrimit në vlerë prej 5 euro (taks administrative e përcaktuar nga kolegji).

2.4 Para fillimit të semestrit, pagesat e studentëve duhet të paguhen në marrëveshje të plotë ose të kënaqshme të pagesës (p.sh. ndihma financiare e aprovuar, aranzhimi i sponsorizimit etj.). Nëse nuk ekzistojnë aranzhime të kënaqshme, studenti nuk mund të lejohet të regjistrohet për semestër ose regjistrimi mund të anulohet.

## **3. Përcaktimi, kur një pagesës e studentit është shkelje:**

3.1 Një pagës mujore (kësti mujor) konsiderohet i/e vonuar pas 5 ditë vonesë.

3.2 Kur pagesa e semestrit nuk është realizuar në afatin e parashikuar për regjistrim.

3.3 Për informacione shtesë vizitoni faqen zyrtare, <https://www.riinvest.net/faqs/> pyetjet e shpeshta dhe kontaktoni administratën dhe zyrën e financave.

#### **4. Metodat e arkëtimit**

4.1 Studentit/ja i/e cili/a që ka llogarinë aktive në MIS dhe kanë obligime financiare konsiderohen detyrues/e sipas kontratës dhe respektim të afateve të pagesave. Në rast kontaktimi 3 herë nga kolegji Riinvest dhe mos reagimi nga studenti dhe vonesë e tejkaluar prej 30 ditë ne do të detyrohemi të kontaktojmë institucionin e përmbaruesit për vazhduar arkëtimin e detyrimeve financiar. Gjatë kësaj periudhe për çdo vonesë do të llogaritet interesi sipas përcaktimit të këtij institucioni.

4.2 Shlyerja e borxhit: Llogaria e studentit e cila ka detyrime financiare gjatë vitit akademik do të ç regjistrohet nga sistemi nëse studenti nuk regjistron semestrin vijues. Studenti nuk ka të drejtë në asnjë shërbim të administratës në formë fizike ose elektronike. Studenti nuk ka të drejtë të marr dosjen origjinale deri në shlyerjen e borxhit ndaj kolegjit.

#### **5. Pagesat e sponsoruara - përgjegjësia për pagesë**

5.1 Përgjegjësia për pagesën e tarifës së studimeve për një afat qëndron tek studentin/prindi sipas kontratës. Nëse kemi të bëjmë me një kompani apo individ sponsorisues dhe i cili nuk paguan shumat e dakorduara në emër të studentit/es/ve deri në ditën e fundit të semestrit, studenti nuk mund të vijoj mësimin pjesëmarrja në provime, dhe marrjen e shërbimeve nga administrata.

#### **Neni 6 – Dispozitat përfundimtare**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Drejtues dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit Drejtues.

Prishtinë,

14 shkurt 2019

---

Rasim Mrlaku, Kryesues